

20252164228

МИНИСТЕРСТВО ЗА ОБРАЗОВАНИЕ И НАУКА

Në bazë të nenit 87 paragrafin (3) të Ligjit për Arsimin e Mesëm (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 42/03, 651/05, 65/04 35/06, 30/07, 49/07, 81/08, 92/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/113, 41/41 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16, 67/17 dhe 64/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 229/20, 78/25 dhe 132/25), ministri i Arsimit dhe Shkencës solli .

R R E G U L L O R E **PËR VLERËSIMIN E NXËNËSVE QË PUNOJNË SIPAS PLANIT ARSIMOR** **INDIVIDUAL DHE PROGRAMIT TË MODIFIKUAR**

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohet vlerësimi i nxënësve të cilët punojnë sipas planit individual arsimor (në tekstin e mëtejme: PIA) dhe programin e modifikuar.

Neni 2

Për vlerësimin e nxënësve të cilët punojnë sipas PIA-në dhe programin e modifikuar, mësimdhënësi:

- planifikon vlerësimin;
- bën përzgjedhjen e metodave specifike për vlerësim dhe përzgjedhjen/përgatitjen e instrumenteve dhe procedurave specifike (teste me shkrim në alfabetin Braj, format të zmadhuar, në version elektronik, në format audio, përdorim të teknologjisë ndihmëse, kohë më të gjatë për zgjidhjen e testit, ndihmë për leximin e pyetjeve nga testi, pushime të mbikëqyrura dhe plan fleksibël mësimor, prania e asistentit arsimor);
- e zbaton procesin e vlerësimit;
- formon notën;
- kryen analizë dhe informimin për njohurit e marra nga vlerësimi dhe
- përdor njohurit nga vlerësimi për planifikimet e ardhshme të mësimdhënies, në bashkëpunim me ekipin shkollor gjithëpërfshirës dhe ekipin gjithëpërfshirës për nxënësin.

Neni 3

Vlerësimi i secilit nxënës përshtatet veçanarishtë bazuar në aftësitë e tyre kognitive, mundësitë dhe mënyrën e shprehjes.

Vlerësimi i nxënësve të cilët ndjekin PIA-në dhe programin e modifikuar bëhet në mënyrën në vijim:

- vlerësimi i njohurive paraprake të nxënësit – vlerësimi diagnostik – vëzhgimi i njohurive, aftësive, shkathtësive dhe qëndrimeve të nxënësit, me qëllim planifikimin edekuat të mësimdhënies;
- vlerësimi formativ, gjegjësisht procesi i vazhdueshëm i ndjekjes, kontrollimit dhe vlerësimit të arritjeve të nxënësve për sigurimin e dëshmime objektive për mënyrën se si nxënësi mëson dhe përparon, dhe në çka tregon rezultate të mira dhe çka duhet të përmirësojë. Rezultatet e nxënësit përdoren për t’i dhënë atij informacion kthyes (feedback), sqarime dhe udhëzime për punën e mëtejshme. Gjatë mësimdhënies, arritjet e nxënësve rregullisht ndiqen dhe vlerësohen, mblidhen treguesit për aktivitetin e tyre, motivimin, angazhimin, përkushtimin në punë, punën në grup dhe

-vlerësimi sumativ,gjegjësishtë, matja e arritjeve të nxënësit në fund të njësisë së caktuar mësimore ose në periudhë të caktuar kohore (tremujor, gjysmëvjetor, fundi i vitit shkollor), ndërsa rezultatet përdoren për të formuar notë për arritjet e deritanishme.

Neni 4

Mësimdhënësi në procesin e vlerësimit përdor metoda dhe instrumente të ndryshme specifike për vlerësim. Metodat dhe instrumentet e vlerësimit janë të lidhura me rezultatet e të nxënësit, standardet për vlerësimin e arritjeve të nxënësve, qëllimin e vlerësimit, llojin e aftësisë së kufizuar dhe aftësitë e mundësitë individuale të nxënësve. Në procesin e vlerësimit përdoren metodat në vijim, në varësi të llojit të aftësisë së kufizuar të nxënësit:

- për kontroll oral (bisedë, diskutim, paraqitje gojore, pyetje me gojë, shprehje joverbale e të mësuarës, përshkrim dhe paraqitje përmes modelimit);
- metoda për vlerësimin e përgjigjeve me shkrim (teste dhe teste të shkruara në alfabetin e Brajlit, përgjigje të pyetjeve), punime të tjera me shkrim (ese, punime letrare, raporte kërkimore) dhe punime (vizatime, modele, paraqitje grafike, portofol);
- metoda për kontrollin e aftësive praktike (prezantime dramatike, muzikore, fizike, punë praktike).

Në procesin e vlerësimit, në përputhje me metodat dhe qëllimin e vlerësimit, përdoren instrumentet e mëposhtme për vlerësim:

- për ndjekjen (vëzhgimin) e përparimit të nxënësit (vlerësim formativ): shënime anekdotike, protokoll për vëzhgim, detyra të destinuara për të gjithë nxënësit, detyra të diferencuara për grup nxënësish ose nxënës, lista verifikimi dhe lista kontrolli;
- për formimin e notës (vlerësim sumativ) përdoren instrumente që sigurojnë objektivitet dhe përfaqësim më të madh, si për shembull: teste, lista analitike për vlerësim, lista holistike për vlerësim dhe portofol.

Neni 5

Për nxënësit të cilët punojnë sipas PIA dhe programit të modifikuar, nota formohet pas përfundimit të njësisë programore (fusha/njësia modulare) dhe periudhën kohore specifike të vitit shkollor (tremujor, gjysmëvjetor dhe fund i vitit shkollor).

Për nxënësit të cilët punojnë sipas PIA-së, nota mund të formohet edhe pas arritjes së rezultateve të përshtatura të të nxënësit të përfshira në PIA, ndërsa për nxënësit të cilët punojnë sipas programit të modifikuar, nota mund të formohet edhe pas arritjes së rezultateve të caktuara të të nxënësit të bazuara në kompetencat sipas programit të modifikuar.

Në notë përfshihen vetëm treguesit për arritjet e rezultateve të përshtatura të të nxënësit që vlerësohen sipas PIA-së / programit të modifikuar.

Neni 6

Nxënësit që ndjekin mësimin sipas PIA-it (Programit Individual të Arsimit) vlerësohen me nota numerike për çdo vit shkollor në arsimin e mesëm, në përputhje me arritjet individuale ndaj qëllimeve të përcaktuara të të nxënësit dhe standardeve për vlerësimin e arritjeve individuale të nxënësit, në lidhje me: kuptimi/arsyetimi i përmbajtjeve të trajtuara, pra aftësia e nxënësit për t'i interpretuar ato me fjalët e veta; zbatimi i përmbajtjeve të mësuara në detyra konkrete me elementë të njohur dhe të rinj, si dhe në situata të tjera të reja; si edhe aftësitë më të larta intelektuale për analizë, sintezë dhe vlerësim, të cilat nënkuptojnë aftësinë e nxënësit për të sistemuar dhe kombinuar elementët në tërësi të reja, si dhe aftësinë për të vlerësuar drejtësinë apo shkencorësinë e një pohimi apo veprë.

Pasi mësimdhënësi të ketë vlerësuar arritjet e nxënësit në përputhje me PIA e hartuar për secilin nga nivelet e përmendura sipas standardeve të vlerësimit (për secilën fushë/njësi modulare), e përcakton notën e nxënësit në mënyrën vijuese:

- nota e pamjaftueshme (1) – nuk arrin as përparim minimal në arritjen e rezultateve të të nxënësit;

- nota e kënaqshme (2) – njohuritë e nxënësit lidhen me memorizimin dhe riprodhimin; nxënësi tregon disa aftësi për të shprehur njohuritë me fjalët e veta dhe për t'i zbatuar në detyra shumë të thjeshta, ose është nxënës që arrin përparim minimal në përvetësimin e PIA-it dhe arritjen e rezultateve të të nxënësit, me angazhimin e nxënësit dhe ndihmë shumë të konsiderueshme nga ana e mësimdhënësit;

- nota mirë (3) – njohuritë e nxënësit, përveç që lidhen me memorizimin dhe riprodhimin, përfshijnë edhe kuptimin dhe kapjen e përmbajtjeve mësimore; nxënësi tregon aftësi për të aplikuar njohuritë në zgjidhjen e detyrave të thjeshta, ose është nxënës që arrin përparim në përvetësimin e IOP-it dhe arritjen e rezultateve të të nxënësit, me angazhimin e nxënësit dhe ndihmë të konsiderueshme nga ana e mësimdhënësit;

- nota shumë mirë (4) – njohuritë e nxënësit përfshijnë memorimin dhe riprodhimin më të plotë, kuptimin dhe kapjen e përmbajtjeve mësimore; nxënësi tregon aftësi për të aplikuar njohuritë në zgjidhjen e detyrave me elementë të njohur dhe të rinj, si dhe aftësi për të organizuar dhe kombinuar elementë në një tërësi të re, ose nxënësi arrin përparim të rëndësishëm në përvetësimin e IPIA-it dhe arritjen e rezultateve të të nxënësit me një nivel të lartë angazhimi të nxënësit dhe ndihmë të pakët nga mësimdhënësi;

- nota shkëlqyeshme (5) – njohuritë e nxënësit përfshijnë mbi 90% të përmbajtjeve të programit mësimor në nivelin e memorizimit, riprodhimit, kuptimit dhe arsyetimit; nxënësi mund t'i aplikojë njohuritë për të zgjidhur detyra me elementë të njohur dhe të rinj, mund të organizojë dhe kombinojë elementë në tërësi të reja dhe të tregojë aftësi për të vlerësuar drejtësinë ose shkencorësinë e një pohimi apo veprimi, ose nxënësi arrin përparim shumë të rëndësishëm në përvetësimin e PIA-it dhe arritjen e plotë të rezultateve të të nxënësit, me një nivel shumë të lartë angazhimi dhe ndihmë minimale nga mësimdhënësi.

Gjatë formimit të notës, mësimdhënësi përdor të gjitha mjetet e plotësuar dhe dëshmitë e mbledhura nga vlerësimi formativ, që janë punët e nxënësve, me qëllim arritjen e objektivitetit në vlerësimin e nxënësit konkret.

Vlerësimi i nxënësve përfshin edhe kontrollime të shpeshta dhe të shkurtra të qëllimeve më të vogla mësimore; kontrollime me shkrim të njohurive duke përdorur detyra për plotësim; krahasime me zgjedhje të dyfishta ose me shumë zgjedhje; kontrollime dhe vlerësime që kanë efekt stimuluese për nxënësin; zhvillimin e një plani motivues, nëse është i nevojshëm; dhe zhvillimin e aftësisë për vetëvlerësim.

Neni 7

Nxënësit që punojnë sipas programit të modifikuar vlerësohen me nota numerike për çdo vit shkollor në arsimin e mesëm, në përputhje me arritjet individuale ndaj qëllimeve të përcaktuara të të nxënësit dhe standardet për vlerësimin e arritjeve individuale, të cilat duhet t'i ndihmojnë ata të fitojnë dhe zhvillojnë njohuri dhe aftësi për vetëvendosje, zhvillim personal, marrëdhënie sociale dhe aftësim për punë.

Gjatë vlerësimit, mësimdhënësi merr parasysh rezultatet e të nxënësit të përcaktuara në programin e modifikuar mësimor, në lidhje me memorizimin dhe riprodhimin e përmbajtjeve mësimore; kuptimin/arsyetimin e përmbajtjeve të trajtuara, si dhe aftësinë e nxënësit për të aplikuar njohuritë e mësuara në detyra konkrete.

Gjatë formimit të notës, mësime dhënësi përdor të gjitha mjetet e plotësuara dhe dëshmitë e mbledhura nga vlerësimi formativ, që janë punët e nxënësve, me qëllim arritjen e objektivitetit në vlerësimin e nxënësit konkret.

Neni 8

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën pas publikimit në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“.

Nr. 18-13406/1
17.10.2025
Shkup

Ministre e Arsimit
dhe Shkencës,
Prof. Dr. **Весна Јаневска**, d.v.